



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM
Nr. 56, datë 24.07.2019

PËR LEJIMIN E KANDIDIMIT TË ZNJ. ARTA VORPSI NË VENDIN VAKANT
PËR GJYQATAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA KUVENDI I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË DATËN 04.03.2019

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Ardian Dvorani	- Kryetar
Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare
Arta Marku	- Anëtare
Margarita Buhali	- Anëtare
Fatjona Memçaj	- Anëtare/Relatore
Fatri Islamaj	- Anëtar
Eriol Roshi	- Anëtar

Asistuar nga sekretare **Dorina Dulaj**,

Me praninë e përfaqësuesit të Avokatit të Popullit, z. **Enio Haxhimihali**, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- z. **Bledar Dervishaj**, përfaqësuesi i autorizuar i Presidentit të Republikës, në mbledhjen e datës **17.07.2019 dhe 24.07.2019**, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDATE PËR GJYQTARE
NË GJYKATËN KUSHTETUESE:** **Znj. Arta Vorpsi**

OBJEKTI: **Urdhërimi i lejimit të kandidimit të znj.Arta Vorpsi, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 04.03.2019.**

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së Këshillit, **znj. Fatjona Memçaj**, mendimin e paraqitur nga përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, z. Enio Haxhimihali, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/c të Ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në datën 04.03.2019, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të ish-gjyqtarit Bashkim Dedja.
2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Kuvendi i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kritereve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.
3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese është edhe znj. Arta Vorpsi .
4. Në zbatim të nenit 125 dhe 149/d të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 7/c të ligjit nr. 8577/2000, të neneve 229, pika 2 e nenit 234, 235, 236, 237, 239 e 240 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese.
5. Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për secilin nga vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.
6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 04.03.2019, relatore për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, znj. Fatjona Memçaj.
7. Znj. Arta Vorpsi, si njëra ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidatja Arta Vorpsi, gjendet e administruar në dosjen e kandidatës.

8. Në datën 10.04.2019, kandidatja Arta Vorpsi është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidates të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidates.

9. Në datën 15.04.2019, kandidatja Arta Vorpsi ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidates.

10. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr. 265 prot, datë 19.04.2019, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 8577/2000 dhe Ligjit nr.115/2016.

11. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidatja Arta Vorpsi , ku tregohet se është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

12. Me shkresën nr.2854/4 prot, datë 03.05.2019, ILDKPKI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidatja Arta Vorpsi e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

13. ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, me shkresën nr.11/28 prot., datë 27.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Arta Vorpsi dhe personat e lidhur me të.

14. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, edhe ky Këshill ka kryer veprimet verifikuese të kërkimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidates Arta Vorpsi dhe personave të lidhur me të.

15. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatës Arta Vorpsi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 17.04.2019, i është drejtuar me kërkesa për informacion institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidatës), si më poshtë:

- a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Kreditit e Shqipërisë, (6) Banka e Parë e Investimeve, (7) Banka Intesa Sanpaolo, (8) Banka Kombëtare Tregtare, (9) Banka Ndërkombëtare Tregtare, (10) Banka Procredit, (11) Banka Raiffeisen, (12) Banka Societe Generale, (13) Banka Tirana dhe (14) Banka Union.
- b) Institucioneve financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë : (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k. (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF, (15) Tirana Factoring & Lease, (16) Tranzit sha, (17) Union Financiar Tiranë.
- c) Subjekteve financiare të licencuar nga AMF : (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit ËVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal.
- ç) Institucione të tjera publike si : (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Tatimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

16. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të treguara në pikën 15 më sipër, kanë dërguar pranë Këshillit përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidaten Arta Vorpsi.

17. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr.110 prot, datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar sipas ligjit nr. 138/2015 nga kandidatja Arta Vorpsi.

18. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr.1134/200 prot., datë 28.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Arta Vorpsi.

19. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatës Arta Vorpsi , në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i është drejtuar me kërkesë për informacion Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (shkresa nr.120 prot, datë 17.04.2019), Shërbimit

Informativ të Shtetit (*shkresa nr.114 prot, datë 17.04.2019*), Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (*shkresa nr.118 prot, datë 17.04.2019*) dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (*shkresa nr.117 prot, datë 17.04.2019*).

20. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në vijim të procedurës së sipërcituar për verifikimin e integritetit, me shkresën nr.352 prot., datë 20.05.2019, i është drejtuar Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar të kërkuar pranë institucioneve përkatëse ligjzbatuese për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve.

21. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësisht me shkresat *nr.1545 prot., datë 10.06.2019* dhe *nr.680/1 prot., datë 15.05.2019*, mbi të dhënat e kërkuara për të gjithë kandidatët, përfshirë edhe kandidaten Arta Vorpsi.

22. Në vijim të procedurave të verifikimit dhe kontrollit të integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të Ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr.112 prot, datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nr. 45/2015 nga kandidatja Arta Vorpsi për kompetencë dhe shqyrtim pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

23. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr.551/1 prot., datë 03.05.2019, ka dërguar vendimin nr. 271 datë 02.05.2019 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Arta Vorpsi.

24. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli ka marrë në shqyrtim dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidatja Arta Vorpsi në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant

25. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, Këshilli në datën 02.05.2019 i është drejtuar më kërkesë për informacion partive politike, si dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (*shkresa nr. 270 prot., datë 19.04.2019*), duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Në përgjigje të këtyre kërkesave, KQZ dhe parti politike kanë dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidaten Arta Vorpsi.

26. Gjithashtu, për këtë rast kandidimi, lidhur me kushtin e parashikuar nga shkronja “d” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi*, me shkresën nr.268 prot, datë 19.04.2019, Këshilli i është drejtuar me kërkesë për informacion Gjykatës Kushtetuese, pranë të cilit kandidatja Arta Vorpsi ka ushtruar dhe vijon ushtrimin e funksioneve publike, për të dërguar të dhëna nëse ka pasur dhe ka masa disiplinore ndaj kësaj kandidateje.

27. Lidhur me të dhënat e kërkuara, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Gjykata Kushtetuese me shkresën nr.144/1 prot, datë 23.04.2019.

28. Së fundi, në lidhje me kandidaten Arta Vorpsi, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 76 datë 12.11.2018 ka vendosur konfirmimin e saj në detyrë, vendim i cili ka marrë formë të prerë në datës 26.12.2018.

29. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikave 29, 75, 87 dhe 94 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, duke vlerësuar paraprakisht se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, anëtarja relatore e Këshillit znj. Arta Marku ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

30. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 17.07.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt urdhërimin e lejimit të kandidimit të znj. Arta Vorpsi, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi në datën 04.03.2019.

31. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidates Arta Vorpsi.

32. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

33. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 17.07.2019, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

34. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

35. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtësuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoji mendimin e

Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatës Arta Vorpsi.

36. Në thelb, Avokati i Popullit, krahas qëndrimit të përgjithshëm se edhe për këtë rast nuk ka pasur nga KED në dispozicion dokumentacionin e plotë ku bashkëlidhur akteve të procedurës së verifikimit mungojnë edhe një pjesë dokumenteve dhe përgjigjeve të sjella nga institucionet, parashtrori se:

- ka mungesë dokumentacioni në dosjen e dërguar pranë Avokatit të Popullit që vërteton plotësimin e kriterëve dhe kushteve të tjera ligjore, mbi bazën e të cilave mund të jepen konkluzione paraprake mbi procedurën e ndjekur
- rekomandohet të verifikohet gjendja penale për periudhën gjatë së cilës ka jetuar jashtë shtetit

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

37. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidatës, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për lejimin e kandidimit të kandidatës Arta Vorpsi për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi në datën 04.03.2019.

38. Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se :

“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret e tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”

39. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*
- b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;*
- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;*
- ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;*
- d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;*
- dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.*

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kriteret:

- a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;
- b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;
- c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”

40. Për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, ILDKPKI, me shkresën nr.11/28 prot., datë 27.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Arta Vorpsi dhe personat e lidhur me të.

41. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruara nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarin e pasurisë dhe interesave private të kandidates Arta Vorpsi, ILDKPKI në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin,
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë,
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë,
- ç) nuk ka kryer deklarim të rremë,
- d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

42. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi përputhshmërinë e të dhënave të deklaruara nga kandidatja Arta Vorpsi në *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë* që ka depozituar pranë ILDKPKI dhe mbi bazën e të cilave ky institucion ka realizuar analizën financiare duke ardhur në përfundimet e tij të sipërcituara, në raport me të dhënat që rezultojnë nga informacionet e dërguara pranë Këshillit nga institucionet publike dhe subjektet private të treguara në pikën 15 të këtij Vendimi.

43. Mbi bazën e verifikimeve të kryera, Këshilli i rezulton se nuk ka gjetje që tregojnë të dhëna të padëklaruara apo mospërputhje të tyre me të dhënat e treguara në deklarinet e bëra nga kandidatja Arta Vorpsi pranë ILDKPKI me *Deklaratën e e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë*.

44. Gjithashtu, Këshilli e vlerësoi të plotë dhe ezaurues, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, hetimin e thelluar dhe analizat e hollësishme financiare të realizuara nga ILDKPKI, sikurse edhe përfundimet e këtij institucioni mbi kontrollin e pasurisë dhe interesave private të kandidates Arta Vorpsi.

45. Për këto arsye, në zbatim të shkronjës “dh” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Arta Vorpsi ka “*kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të saj*”. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, kjo kandidate nuk rezulton të jetë në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.

46. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, kandidatja Arta Vorpsi ka dorëzuar në afat formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015 “*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*”, të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Prokurorisë së Përgjithshme.

47. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr.1134/200 prot., datë 28.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Arta Vorpsi, duke ardhur përfundimet se *“Subjekti deklarues Arta Garip Vorpsi kandidatë për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*”.

48. Prandaj, nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Prokuroria e Përgjithshme sipas ligjit, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Arta Vorpsi, krahas plotësimit të saktë të formularit të vetëdeklarimit, përmbush kushtin e parashikuar nga shkronja “ç” e nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *“ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;”*. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kjo candidate nuk rezulton të jetë në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

49. Në vijim të procedurave të verifikimit të integritetit, kandidatja Arta Vorpsi ka dorëzuar në afat formularin e aplikimit *“Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta”* parashikuar në ligjin nr. 45/2015, të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

50. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr.551/1 prot., datë 03.05.2019, ka dërguar vendimin nr.271 datë 02.05.2019 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Arta Vorpsi, duke ardhur në përfundimin se për zonjën Arta Vorpsi, *“nga verifikimet e kryera deri tani, nuk figuron të ketë materiale, në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, në emër të saj, sipas Nenit 29, pika 2 të Ligjit Nr.45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*”.

51. Prandaj, nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Arta Vorpsi, krahas plotësimit të saktë të formularit përkatës të aplikimit, përmbush kushtet e parashikuara nga ligji nr. 45/2015 për pastërtinë e figurës së funksionarit kushtetues në lidhje me sjelljen dhe veprimtarinë tij përpara datës 2 Korrik 1991. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kjo candidate nuk rezulton të jetë në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

52. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi, nëpërmjet informacionit të sjellë sipas ligjit nga organe kompetente ligjzbatuese si Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi Informativ i Shtetit, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme, nëse kandidatja Arta Vorpsi *“ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar”*. Ky verifikim përbën standardin kushtetues dhe ligjor tashmë të vendosur për figurën dhe integritetin e funksionarëve kushtetues të sistemit të drejtësisë, përpara zgjedhjes dhe gjatë ushtrimit të funksionit, pas ndryshimeve të Kushtetutës në vitin 2016, duke pasur parasysh ato të përcaktuara edhe në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si edhe në ligjet e tjera të nxjerra në pajtim me të, përfshirë ligjin nr. 84/2016, pra mbi të njëjtat standarde dhe interpretim të këtij kriteri në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

53. Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme, me shkresën nr.680/1 prot., datë 15.05.2019, ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi informacionin e kërkuar për verifikimin e rastit të treguar në pikën 52 më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidaten Arta Vorpsi “*nuk figuron e evidentuar për veprimtari kriminale.*”.

54. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr.1543 prot., datë 10.06.2019, ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi informacionin e përpunuar sipas standardeve ligjore dhe profesionale për këtë kategori informacionesh, të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese të cituara në pikën 52 më sipër, nga ku rezulton se “*nuk disponohen materiale implikuese ose kompromentuese për integritetin e figurës së znj. Arta Vorpsi.*”.

55. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, bazuar në njohjen dhe shqyrtimin e informacionit të dërguar nga agjencitë ligjzbatuese, vjen në përfundimin se, edhe për këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kandidatja Arta Vorpsi nuk rezulton të jetë në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

56. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga vetë kandidatja Arta Vorpsi në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant, si edhe përgjigjet nga informacionet e kërkuara nga institucionet publike dhe subjektet private ku kjo kandidatë ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të saj.

57. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “b” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidatja të ketë *mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë*, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidatja Arta Vorpsi ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 1996 si juriste, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë. Për rrjedhojë kandidatja Arta Vorpsi nuk rezulton të jetë në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

58. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidatja të ketë *të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike*, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidatës, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidatja Arta Vorpsi ka ushtruar veprimtari profesionale si :

- a) Asistent avokat, për periudhën 1996-1997;
- b) Specialiste e Marrëdhënieve me Jashtë për periudhën 1997-1998 pranë Gjykatë Kushtetuese;
- c) Nëpunës i nivelit të lartë në administratën publike, Drejtore e Drejtorisë së Studimeve dhe Botimeve pranë Gjykatës Kushtetuese, për periudhën 2001-2005;
- ç) Këshilltare ligjore pranë Gjykatë Kushtetuese, për periudhën 2005 dhe aktualisht,

- d) Gjyqtare ad hoc, për periudhën 2015 e në vijim, pranë gjykatës Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut ;
- dh) Pedagoge e jashtme e së drejtës kushtetuese, e së drejtës kushtetuese të krahasuar, si dhe e të drejtave të njeriut (e angazhuar me kohë të pjesshme), pranë Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, Shkollës së Magjistraturës dhe në Shkollat e Larta Jopublike “Luarasi” dhe “Universiteti European i Tiranës”.

59. Bazuar në gjetjet e cituara në pikën 58 më sipër, Këshilli konstaton se kandidatja Arta Vorpsi ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

60. Për sa i përket kushtit të kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidatja të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, sikurse parashtrohet në pikën 58 më sipër, si edhe nga jetëshkrimi dhe aktet e administruara në dosjen e kandidatës për veprimtaritë e tjera të ushtruara, Këshilli konstaton se kandidatja Arta Vorpsi nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike (gjatë 10 viteve të fundit të kandidimit). Për rrjedhojë kandidatja Arta Vorpsi nuk rezulton të jetë në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

61. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidatja të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, nga shqyrtimi i jetëshkrimit dhe të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen e kandidatës për veprimtaritë e ushtruara prej saj, si edhe shkresat me përgjigje të dërguara sipas kërkesës së Këshillit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe nga parti politike, Këshilli konstaton se kandidatja Arta Vorpsi nuk rezulton që të ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike (gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit). Për rrjedhojë kandidatja Arta Vorpsi nuk rezulton të jetë në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

62. Në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidatja të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, informacioni i dërguar nga Gjykata Kushtetuese me shkresën nr.144/1 prot, datë 23.04.2019, që janë të administruara në dosjen e kandidatës, Këshilli i rezulton se, gjatë marrëdhënies së punës me Gjykatën Kushtetuese, kandidatja Arta Vorpsi nuk ka marrë dhe nuk ka asnjë masë disiplinore apo administrative të regjistruar, që nga fillimi i marrëdhënieve të punës. Për rrjedhojë kandidatja Arta Vorpsi nuk rezulton të jetë në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

63. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacioni që përmban dosja e kandidatës, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset lejimi i kandidimit të kandidatës Arta Vorpsi në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 04.03.2019.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/a dhe 7/c të ligjit nr. 8577/2000 “ *Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*”, të pikës 3 të nenit 229, pikës 4 të nenit 235, pikës 5 të nenit 236 dhe pikës 3 të nenit 237 të Ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, si edhe të shkronjës “a” të pikës 50 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

VENDOSI:

1. Lejimin e kandidimit të kandidatës Arta Vorpsi, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 04.03.2019.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatës Arta Vorpsi.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

ARDIAN DVORANI

